



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.101

3 gusht

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.436, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë”, të ndryshuar.....	2867
Vendim i KM nr.437, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.366, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Burgjeve”....	2874
Vendim i KM nr.438, datë 13.7.2007	Për pagat e punonjësve të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.....	2876
Vendim i KM nr.439, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, të ndryshuar	2877
Vendim i KM nr.440, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve mësimorë, në arsimin parauniversitar”, të ndryshuar.....	2879
Vendim i KM nr.441, datë 13.7.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr. 370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të administratës së prefektit”	2881
Vendim i KM nr.442, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit, të funksionimit dhe pagat e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”, të ndryshuar.....	2883
Vendim i KM nr.443, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të Avokatit të Popullit”, të ndryshuar.....	2884

Vendim i KM nr.444, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.456, datë 3.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të punonjësve të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar.....	2885
Vendim i KM nr.445, datë 13.7.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.785, datë 22.11.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të organikës dhe të strukturës e të nivelit të pagave, të nëpunësve dhe punonjësve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”.....	2886
Vendim i KM nr.446, datë 13.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për funksionet drejtuese dhe për strukturën e nivelet e pagave në Ministrinë e Punëve të Jashtme”.....	2887
Vendim i KM nr.447, datë 13.7.2007	Për rritjen e pensioneve suplementare të ushtarakëve, të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të trajtimeve të veçanta financiare	2888
Vendim i KM nr.449, datë 18.7.2007	Për pagat e punonjësve civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak ...	2889
Vendim i KM nr.450, datë 18.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.558, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të Policisë së Shtetit, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës, në Ministrinë e Brendshme”.....	2890
Vendim i KM nr.451, datë 18.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për pagat sipas gradave për punonjësit, oficerë dhe nënoficerë, të Gardës së Republikës së Shqipërisë”.....	2892
Vendim i KM nr.452, datë 18.7.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.369, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të sistemit tatimor”.....	2893
Vendim i KM nr.453, datë 18.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagës së punonjësve të doganave”, të ndryshuar.....	2895
Vendim i KM nr.454, datë 18.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.....	2897
Vendim i KM nr.455, datë 18.7.2007	Për pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit pyjor...	2899
Vendim i KM nr.475, datë 13.7.2007	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.....	2900
Vendim i KM nr.476, datë 18.7.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit”.....	2906

Vendim i KM nr.477, datë 13.7.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.....	2910
Vendim i KM nr.478, datë 18.7.2007	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës	2917
Vendim i KM nr.480, datë 1.8.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.216, datë 18.4.2007, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”	2936

VENDIM
Nr.436, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS NË SISTEMIN E MINISTRISË SË
SHËNDETËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, (Krerët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8), e përmendur në pikën 1, të vendimit nr.638, datë 18.9.2003, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore, të planifikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA Nr.1
(Kreu 1.1)

Struktura e pagave për punonjësit e infermjeristikës në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, Spitalin Universitar Obsetrik Gjinekologjik Tiranë, Spitalin e Sëmundjeve të Mushkërisë “Shefqet Ndroqi” Tiranë, Klinikën Stomatologjike Universitare Tiranë

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermjere		2%	0	20200	3600	Nga..deri ...Leke
2	Kryeinfermjer shërbimi psikiatrik		2%	0	20200	6000	Nga..deri ...Leke
3	Kryelaborantë në shërbimin e anatomisë patologjike Kryeinfermjer shërbimi i terapisë intensive Kryeinfermjere shërbimi onkologjik Kryelaborant rezatim kobalti Kryelaborant në histopatologji Kryeinfermjerë të repartit të rezatimit		2%	0	20200	3400	Nga..deri ...Leke
4	Kryeinfermjerë repartit psikiatrik		2%	0	20200	5000	Nga..deri ...Leke
5	Kryeinfermjerë shërbimi neurokirurgji Kryemami e përgjithshme Kryeinfermjer/kryemami repartit i terapisë intensive		2%	0	20200	2600	Nga..deri ...Leke
6	Kryeinfermjerë kimioterapi Kryelaborant klinik biokimik Kryeinfermjere në urgjencën e sëmundjeve të brendshme Kryeinfermeje/mami salle Kryeinfermjere/mami e dhomës së zgjimit Infermjerë në hemodinamikë Kryelaborant		2%	0	20200	1800	Nga..deri ...Leke

	imunolog,bakteriolog.						
7	Kryeinfemjërë shërbimi (kirurgji,neurologji,djegje plastik,kadiokirurgji,maksilofa cial,infektiv,pediatric infektive,obsetrik) Kryeinfemjër/kryemami në repartin e kirurgjisë Kryemami turni në kirurgji Kryemami turni në obsetrikë Kryeinfemjërë reparti infektiv Kryeinfemjërë reparti (fizioterapi,urologji,urgjencës së neurologjisë,neurokirurgji, onkologji) Kryeinfemjërë/kryemami salle operacioni		2%	0	20200	1100	Nga..deri ...Leke
8	Kryeinfemjërë shërbimi , Kryelaborante shërbimi Kryemami shërbimi		2%	0	20200		Nga..deri ...Leke
9	Infermjërë/laborant në psikiatri		2%	0	18800	5000	Nga..deri ...Leke
10	Infermjërë në kyriterapi Laborant histopatolog		2%	0	18800	3400	Nga..deri ...Leke
11	Infermjërë/Mami reanimacioni, neonatologji Infermjërë ne dhomën e zgjimit		2%	0	18800	2650	Nga..deri ...Leke
12	Infermjërë në kimioterapi		2%	0	18800	1800	Nga..deri ...Leke
13	Kryelaborant radiologjie		2%	0	18800	1500	Nga..deri ...Leke
14	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermjërore Kryeinfemjërë e edukimit shëndetësor TB		2%	0	18800	1100	Nga..deri ...Leke
15	Kryeinfemjërë në repartin e alergologjisë. Kryeinfemjërë në sterilizim. Kryemami në izolim.		2%	0	18800		Nga..deri ...Leke
16	Laborant radiolog në onkologji		2%	0	17290	3700	Nga..deri ...Leke
17	Laborant rezatim kobalti		2%	0	17290	3400	Nga..deri ...Leke
18	Laborant në mjeksinë bërthamore		2%	0	17290	2650	Nga..deri ...Leke
19	Infermjërë në njësinë e		2%	0	17290	2100	Nga..deri

	inspektoriati sanitar dhe infeksioneve nazokomiale Infermjerë në sallën e operacionit						...Leke
20	Kryeinfermjer reparti pranim urgjence Laborant klinik biokimik Infermjer në punktin e gjakut Infermjer në hematologji Infermjer në onkologji Infermjere endoskopie Infermjer/laborant bakterilog,imunolog		2%	0	17290	1800	Nga..deri ...Leke
21	Infermjere reparti radilologjik Laborant radiolog Kryeinfermjere (pranim urgjence,djegje plastike ,kirurgji)		2%	0	17290	1500	Nga..deri ...Leke
22	Infermjere /mami (kirurgji, maksilofaciale,neurokirurgji, kardiokirurgji,djegje plastike, obsetrike) Instrumentarë		2%	0	17290	1100	Nga..deri ...Leke
23	Kryeinfermjerë neonatologji Kryemami në qendrën e gruas Kryemami pranimi Kryeinfermjere në kabinetin e dializës Kryemami /Kryeinfermjerë reparti Kryeinfermjerë konsultash në sëmundjet e brendshme Kryelaborant bakterolog,imunolog,ortopedi stomatologjike) Infermjerë sterilizimi		2%	0	17290		Nga..deri ...Leke
24	Infermjerë pavioni rezatimi		2%	0	15090	3310	Nga..deri ...Leke
25	Infermjerë (infektiv,pranim urgjence,njësia e kordinimit të urgjencës)		2%	0	15090	1800	Nga..deri ...Leke
26	Ndihmës farmacist Infermjerë në hemodializë		2%	0	15090	1500	Nga..deri ...Leke
27	Infermjer fizioterapi		2%	0	15090	1100	Nga..deri ...Leke

28	Laborant (ezhe,ortopedi,stomatologji) Kryeinfermjerë çerdhe për personelin Infermjer		2%	0	15090		Nga..deri ...Leke
29	Infermjer çerdhe për personelin Kujdestar në pediatri		2%	0	13270		Nga..deri ...Leke
30	Kujdestar në psikiatri		2%	0	13270	5000	Nga..deri ...Leke

LIDHJA 1
(Kreu 1.2)

**Struktura e pagave për punonjësit e infermjeristikës në Drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethe,
Shërbimet e Kujdesit Shëndetësor Parësor, Autoritetin Shëndetësor Rajonal të Tiranës dhe
Administratës së Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter**

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E POZICIONIT		
	EMËRTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Shef i sektorit të kujdesjeve infermjere		2%	0	20200		Nga..deri ...Leke
2	Specialist i sektorit të kujdesjeve infermjere Kryeinfermjer i përgjithshëm		2%	0	18800		Nga..deri ...Leke
3	Ndihmës inspektor sanitar,ndihmës higjenist, Ndihmës epidemiolog Laborantë toksikologë		2%	0	17290	1100	Nga..deri ...Leke
4	Infermjerë në shërbimet e shëndetit mendor		2%	0	17290	5000	
5	Infermjerë (hematologji,onkologji) Laborant rontgeni		2%	0	17290	1500	
6	Infermier statistike		2%	0	16630		Nga..deri ...Leke
7	Infermjer ortopedi Infermjer/laborant në fizioterapi		2%	0	15090	1100	
8	Kryeinfermjer/kryemami Infermjer në shërbimin stomatologjik Laborant bakterolog/klinik biokimik Ndihmës dentist		2%	0	15090		
9	Ndihmës bakterolog Infermjer/mami		2%	0	13800		

LIDHJA 1
(Kreu 1.3)

Struktura e pagave për punonjësit e infermjeristikës në Spitalet e rretheve, Qendrën e Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve Tiranë

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer i përgjithshëm në spitalet psikiatrike		2%	0	20200	6000	Nga..deri ...Leke
2	Kryeinfermjer reparti në spitale psikiatrike		2%	0	20200	5000	Nga..deri ...Leke
3	Kryeinfermier i përgjithshëm		2%	0	20200	1100	Nga..deri ...Leke
4	Laborant në anatominë patologjike		2%	0	18800	3400	Nga..deri ...Leke
5	Kryelaborant në laboratorin klinik biokimik, bakterologjik Kryeinfermjer (kirurgji , reanimacion, sallë operacioni, obsetrikë gjinekologji)		2%	0	18800	1100	Nga..deri ...Leke
6	Kryeinfermjer		2%	0	18800		Nga..deri ...Leke
7	Infermjere në psikiatri Laborant në psikiatri		2%	0	17290	5000	Nga..deri ...Leke
8	Infermjere reanimacioni Ndihmës anesteziistë Ndihmës farmacistë Laborant radiologjie Infermjere në radiologji Instrumentare Infermjere në hemodializë		2%	0	15090	1500	Nga..deri ...Leke
9	Kryeinfermjer në poliklinik e spitalit Infermjer (fizioterapi, ergoterapi, logoterapi, neuropsikiatri, infektiv, dispanceri të sëmundjeve ngjitese, kirurgji, ortopedi, obsetrikë, gjinekologji, pneumoftiziatri,		2%	0	15090	1100	Nga..deri ...Leke

	onkologji,dispanceri) Infermjerë në repartin e lindjes Infermjer/laborant në bankën e gjakut , hematologji. Infermjer/laborant në bankën e gjakut , hematologji. Përgjegjës turni						
10	Kryeinfermjere në qendrën e sterilizimit Infermjer pranim urgjence Laborant klinik biokimik /bakteriologjik		2%	0	15090	600	Nga..deri ...Leke
11	Infermjer		2%	0	15090		Nga..deri ...Leke
12	Kujdestar në psikiatri		2%	0	13270	5000	Nga..deri ...Leke
13	Kujdestar në pediatri Ndihmës infermjer		2%	0	13270	3300	Nga..deri ...Leke

LIDHJA 1
(Kreu 1.4)

Struktura e pagave për laborantët në Laboratorin e Kontrollit të Barnave

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Laborant		2%	0	20200		Nga..deri ...Leke

LIDHJA 1
(Kreu 1.5)

Struktura e pagave për punonjësit e infermjeristikës në Klinikën e Shërbimeve Mjekësore

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per pozicion (SHP)	Shtesa per kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer		2%	0	20200		Nga..deri ...Leke
2	Infermjer Ndihmës stomatologë		2%	0	15090		Nga..deri ...Leke

LIDHJA 1
(Kreu 1.6)

Struktura e pagave për punonjësit e infermjeristikës në Qendrën Kombëtare të Kontrollit të Gjakut

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Kryeinfermjer Kryelaborant		2%	0	18800		Nga..deri ...Leke
2	Infermjer Laborant		2%	0	15090	1100	Nga..deri ...Leke

LIDHJA I
(Kreu 1.7)

Struktura e pagave për teknikët në Njësinë e Transportit Mjekësor me Helikopterë

		PAGA MUJORE					
		PAGA INDIVIDUALE			SHTESA E POZICIONIT		
	EMERTIMI	Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Shtesa për kushte pune (SHKP)	Totali
		1	2	3	4	5	
1	Teknik i përgjithshëm, Teknik elektrik		2%	0	18800		Nga..deri ...Leke

VENDIM
Nr.437, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.366, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË BURGJEVE”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr.8321, datë 2.4.1998 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.366, datë 14.6.2006, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Burgjeve

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi	
			në funksion të policisë të regjimeve të jashtme.	në funksion të policisë të regjimeve të brendshme dhe transferim shoqërimet.
1	2	3	4	5
Bazë	Agjent	31350	4000	7000
	Agjent i I-rë	32400	4000	7000
	Asistent	33600	4000	8000
	Asistent i I-rë	35000	4000	8000
	Kryeasistent	36100	4000	8000
I Mesëm	Neninspektor	46000	4000	6000
	Inspektor	48300	4000	6000
	Kryeinspektor	54250	4000	6000
I lartë	Nënkomisar	65900	4000	6000
	Komisar	80900	4000	6000
	Kryekomisar	92400	4000	6000
Madhor	Drejtues	102000	8000	
	Drejtues i I-rë	109500	8000	

VENDIM
Nr.438, datë 13.7.2007

PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 35 të ligjit nr.8766, datë 5.4.2001 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin”, dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga bazë për gradë (kolona 3), e lidhjes nr.1, është niveli i pagës së punonjësit të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përputhje me gradën, që ka fituar.

3. Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi (kolona 4) e lidhjes nr.1 jepet sipas funksioneve të veçanta të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

4. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

5. Vendimi nr.54, datë 27.2.1992 i Këshillit të Ministrave “Për sistemin e pagave të Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar, duke filluar nga data 1 korrik 2007, nuk do të zbatohet për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit

Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune e shërbimi
1	2	3	4
Bazë	Agjent	31350	7000
	Agjent i I-rë	32400	7000
	Asistent	33600	8000
	Asistent i I-rë	35000	8000
	Kryeasistent	36100	8000
I Mesëm	Nëninspektor	46000	6000
	Inspektor	48300	6000
	Kryeinspektor	54250	6000
I lartë	Nënkomisar	65900	6000
	Komisar	80900	6000
	Kryekomisar	92400	6000
Madhor	Drejtues	102000	
	Drejtues i I-rë	109500	

VENDIM
Nr.439, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në pikën 3. c) tabelat nr.2 “Pasqyra e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në qendër” dhe “Pasqyra e pagave për punonjësit e degëve të policisë së ndërtimit në rrethe” zëvendësohen me tabelat me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.12. 2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela Nr. 2**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË
NDËRTIMIT NË QENDËR**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Drejtör		II-a
2.	Zevendesdrejtör		II-b
3.	Kryetar Dege	XXII	36700
4.	Shef Sektori	XXII	36700
5.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXII	36700
6.	Specialiste	XXI	34500
7.	Shofer	IX	19900
8.	Punonjes Grupi Gadishmerie	XIX	29300
9.	Arkivist. Dkatilografist. Protokollist	VI	17500
10.	Magazinier	VI	17500
11.	Sekretare, daktilografiste.	VI	17500
12.	Punonjes Sherbimi	III	16400
13.	Pastruese	I	16000

Tabela Nr. 2**PASQYRA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E DREJTORISË SË POLICISË SË
NDËRTIMIT NË RRETHE**

Nr.	EMERTIMI	KLASA	PAGA NE LEKE
1.	Kryetar Dege K1	XXII	36700
2.	Kryetar Dege K2	XXI	34500
3.	Shef Sektori	XXI	34500
4.	Specialist i larte	XX	31300
5.	Specialist i mesem	VIII	18800
6.	Kryetar Grupi Gadishmerie	XXI	34500
7.	Specialist Grupi Gadishmerie	XIX	29300
8.	Arkivist - Protokollist	VI	17500
9.	Shofer	IX	19900

**VENDIM
Nr.440, datë 13.7.2007****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.194, DATË 22.4.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE
MËSIMORË, NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.194, datë 22.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 “Struktura e pagës për punonjësit mësimorë”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, të parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij

vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

STRUKTURA E PAGËS PËR PUNONJËSIT MËSIMORË

	EMËRTIMI	PAGA MUJORE				
		PAGA INDIVIDUALE			SHITESA E PROFESIONIT	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa për pozicion (SHP)	Totali
		1	2	3	4	5 = (1+2+3+4)
1	Drejtor i shkollës së mesme. Përgjegjës poligoni. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Drejtor në shkollat me probleme të larta mendore. Drejtor i konvikteve.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	35560	
2	Zëvendës drejtor i shkollës së mesme. Përgjegjës i bazës prodhuese. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk shikojnë. Zëvendës drejtor i institutit të nxënësve që nuk dëgjojnë. Zëvendës drejtor në shkollat me probleme të larta mendore.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	28500	
3	Drejtor i shkollës 8-vjeçare.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	27950	
4	Drejtor i shkollës fillore klasa I-IV-ërt. Përgjegjës (kryemesues) i shkollës me klasë kolektive. Zëvendës drejtor i shkollës 8-vjeçare.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	25800	
5	Drejtor i kopshtit me ushqim.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	24200	

6	Drejtor i kopshtit pa ushqim.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	22070	
7	Mësues në shkollat e mesme. Mësues në institutin e nxënësve që nuk shikojnë. Mësues në institutin e nxënësve që nuk dëgjojnë. Mësues në shkollat me probleme të larta mendore.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	25750	
8	Mësues në shkollat 8-vjeçare, klasa I-VIII. Edukator konvikti. Kujdestar konvikti.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	21560	
9	Edukator në kopësht fëmijësh.	1	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	15900	
10	Mësues	2	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	17600	
11	Mësues	3	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	17600	
12	Edukator në kopësht fëmijësh.	3	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	15750	
13	Edukator në kopësht fëmijësh.	2	2% e P.G .	5 % e P.G 10% e P.G 20% e P.G	15750	

VENDIM
Nr.441, datë 13.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.370, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.370, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
 - a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

 - a) Prefekt i qarkut Tiranë 110 000 lekë;
 - b) Prefekt i qarqeve të tjera 102 000 lekë;
 - c) Nënprefekt i nënprefekturave Kavajë dhe Lushnjë 87 000 lekë;
 - ç) Nënprefekt në nënprefekturat Krujë, Pogradec, Librazhd, Tepelenë, Përmet, Mat, Sarandë, Pukë, Tropojë dhe Skrapar 81 000 lekë;
 - d) Nënprefekt në nënprefekturat Malësi e Madhe, Bulqizë, Peqin, Gramsh, Devoll,

Mallakastër, Has, Kuçovë, Mirditë, Delvinë, Kurbin dhe Kolonjë 74 000 lekë;

dh) Këshilltar i prefektit të Tiranës 57 000 lekë;

e) Zëdhënës i prefektit të Tiranës 47 000 lekë.”.

b) Lidhja nr.1 e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2007 që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 1

EMERTIMI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e Grupit (PG) leke	Shtesa Vjetore per Vjetersi (SHV) pergindje	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Sekretar i Pergjithshem ne Prefekturë.	III-a	10.050	2%	0	65.000
Sekretar i Pergjithshem ne Nenprefekturat Kavaje dhe Lushnje.	III-a/1	10.050	2%	0	55.000
Pergjegjes Sektori ne Prefekturë.	III-b	10.050	2%	0	49.000
	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Pergjegjes Zyre ne prefekturë. Pergjegjes Zyre ne nenprefekturë	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Pergjegjes Sektori ne Nenprefekturë. Inspektor auditit ne Prefekturë.	IV-a	10.050	2%	0	37.450
Specialist ne Prefekturë.	IV-b	10.050	2%	0	25.850
	IV-c	10.050	2%	0	19.900
Specialist ne Nenprefekturë.	IV-c	10.050	2%	0	19.900
Sekretar.	IV-c	10.050	2%	0	19.900

VENDIM
Nr.442, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.108, DATË 11.2.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT, TË FUNKSIONIMIT DHE PAGAT E
PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË
PASTRIMIT TË PARAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 7, të vendimin nr.108, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

EMERTIMI	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIO NIT
	I	2	3	4	5
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHK)	Shtesa per Kualifikim (SHP)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Drejtor i Pergjithshem	II-a	10.050	2%	0	100.500
Zv/drejtor i Pergjithshem	II-b	10.050	2%	0	84.000
Drejtor	III-a/1	10.050	2%	0	55.000
Pergjegjes sektori	III-b	10.050	2%	0	49.000
Specialist	IV-a	10.050	2%	0	37.450
	IV-b	10.050	2%	0	25.850

VENDIM
Nr.443, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.500, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË AVOKATIT TË POPULLIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1 të vendimin nr.500, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare edhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

KLASA	EMERTIMI	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për Vjetërsi (SHK)	Shtesa për Kualifikim (SHP)	Shtesa për Pozicion (SHP) leke
I - a	Sekretar i Përgjithshëm	10.050	2%	0	123.000
II - a	Ndihmeskomisioner kategoria e parë	10.050	2%	0	100.500
II - b	Ndihmeskomisioner kategoria e dytë. Drejtor Drejtorie	10.050	2%	0	84.000
III - a	Përgjegjës sektori	10.050	2%	0	65.000
IV - b	Specialist	10.050	2%	0	25.850

VENDIM
Nr.444, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.456, DATË 3.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.456, datë 3.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

KLASA	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIO NIT
		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
	I-a	10.050	2%	0	84.000
II	II-a	10.050	2%	0	65.000
II	II-b	10.050	2%	0	49.000
III	III-a	10.050	2%	0	37.450

VENDIM
Nr.445, datë 13.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.785, DATË 22.11.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, TË ORGANIKËS DHE TË
STRUKTURËS E TË NIVELIT TË PAGAVE, TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË
KËSHILLIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 20 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.785, datë 22.11.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:
a) Lidhja nr.3, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 8, “vlera 31 764” zëvendësohet “me vlerën 35 900”.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, , të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR. 3

Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve të administratës së Këshillit
Kombëtar të Kontabilitetit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor ekzekutiv.	II-b	10.050	2%	0	84.000
Inspektor	III-a	10.050	2%	0	65.000
Specialist.	IV-b	10.050	2%	0	25.850

VENDIM
Nr.446, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË
JASHTME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1, e përmendur në pikën 1 të vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

POZICIONI DREJTUES	GRADA DIPLOMATIKE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA PER GRADE
	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
		Paga e grupit (PG) leke	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
Sekretar i Përgjithshëm	Ambasador	10.050	2%	0	110.900
Drejtor i Përgjithshëm	Minister Fuqiplote. Minister Keshilltar. Konsull i Përgjithshëm.	10.050	2%	0	100.500
Drejtor	Keshilltar.	10.050	2%	0	84.000
Përgjegjës Sektori	Sekretar i Pare. Konsull.	10.050	2%	0	65.000
	Sekretar i Dytë. Zevendes konsull.	10.050	2%	0	49.000
	Sekretar i Tretë. Agjent Konsullor.	10.050	2%	0	37.450
	Atashe	10.050	2%	0	25.850

VENDIM
Nr.447, datë 13.7.2007

**PËR RRITJEN E PENSIONEVE SUPLEMENTARE TË USHTARAKËVE, TË PUNONJËSVE
TË POLICISË SË SHETITIT DHE TË TRAJTIMEVE TË VEÇANTA FINANCIARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të ligjit nr.9128, datë 29.7.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.9361, datë 24.3.2005 “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”, të ligjit nr.8685, datë 9.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës bëhen të paafte plotësisht, pensionet suplementare familjare, pensionet suplementare familjare të ushtarakëve, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ Shtetëror”, të ndryshuar, dhe pensionet familjare, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8455, datë 4.2.1999 “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 30.6.2007, përfshirë dhe kjo datë, të rriten në masën 3 për qind.

2. Pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, pensionet suplementare të pleqërisë, pensionet suplementare të invaliditetit, pensionet suplementare të invaliditetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, bëhen të paafte plotësisht, pensionet suplementare familjare dhe pensionet suplementare familjare të punonjësve të Policisë së Shtetit, që, për shkak të detyrës, humbasin jetën, të caktuara në mbështetje të ligjit nr.8661, datë 18.9.2000 “Për sigurimin suplementar të punonjësve të Policisë së Shtetit”, të rriten në masën 3 për qind.

3. Trajtimi i veçantë financiar i pilotëve fluturues në pension të rritet në masën 3 për qind.

4. Trajtimi i veçantë financiar i efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues, të nëndetësve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension, të rritet në masën 3 për qind.

5. Trajtimi i veçantë i punonjësve, që kanë punuar në miniera në nëntokë, të rritet në masën 3 për qind.

6. Trajtimi i veçantë i punonjësve të disa ndërmarrjeve ushtarake të rritet në masën 3 për qind.

7. Rritjen, në masën 3 për qind, sipas pikave 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6 të këtij vendimi, do ta përfitojnë të gjitha përfitimet e caktuara, me datë fillimi deri në 30.6.2007, përfshirë edhe këtë datë.

8. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 55 milionë lekë dhe të përballohen nga buxheti i vitit 2007, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.449, datë 18.7.2007

PËR PAGAT E PUNONJËSVE CIVILË TË SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 3 të nenit 9 të ligjit nr.9295, datë 21.10.2004 “Për kriteret e pranimit, karrierën dhe ndërprerjen e saj në Shërbimin Informativ Ushtarak”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave, sipas funksioneve organike, për punonjësit civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak, të jenë sipas lidhjes nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave sipas funksioneve organike, për punonjësit civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit, diplomë për arsimin e lartë (kolona 1) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë në muaj.

3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 2) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 3) e lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, është 0.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4 të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Punonjësit e tjerë civilë të Shërbimit Informativ Ushtarak, që nuk përmenden në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të trajtohen, në pagë, sipas lidhjes II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrave dhe institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

7. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave sipas funksioneve organike, për punonjësit civile të Shërbimit Informativ Ushtarak

Nr.	Pozicioni	PAGA INDIVIDUALE			PAGA MUJORE	
		Kateg- oria	Paga e Grupi t (PG)	Shtesa vjetore për Vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualif ikim (SHK)	Shtesa e Pozicioni t (SHP)
			1	2	3	4
1	Drejtor	II-b	10050	2%	0	84000
2	Zv/drejtor operacional	III-a	10050	2%	0	65000
3	Zv/drejtor mbështetës	III-a	10050	2%	0	65000
4	Shef shërbimi operacional	III-a	10050	2%	0	65000
5	Shef sektori operacional	III-a/1	10050	2%	0	55000
6	Shef sektori mbështetës	III-a/1	10050	2%	0	55000
7	Shef zyre drejtori	III-b	10050	2%	0	49000
8	Shef Përgjegjës zyre operacional	III-b	10050	2%	0	49000
9	Shef Përgjegjës zyre mbështetës	III-b	10050	2%	0	49000
10	Inspektor i Përgjithshëm	III-b	10050	2%	0	49000
11	Këshilltar juridik	III-b	10050	2%	0	49000
12	Analist	IV-a	10050	2%	0	37450
13	Specialist	IV-a	10050	2%	0	37450
14	Inspektor	IV-b	10050	2%	0	25850

**VENDIM
Nr.450, datë 18.7.2007**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.558, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHETIT, TË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, INSPEKTIMIT TË PËRGJITHSHËM
DHE SHIFRËS, NË MINISTRINË E BRENDSHME ”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit, SHKB-së, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës, në Ministrinë e Brendshme”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.558, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

Lidhja nr.1
Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shetit, SH.K.B, Inspektimit të Përgjithshëm dhe Shifrës në Ministrinë e Brendshme

Shtesa për natyrë të veçantë pune dhe shërbimi														
Roli	Grada	Paga bazë për gradë	Ne funks L.K.Kri m it Organiz ar. Nj. Ope rat.st.O peru.ne D.Forc e	Ne funks F. Posaç.d he O.P.Gjy q.prane Prok. Per krimet e Renda	Ne funks L.K.A.T. K.H Gj.tek.Ve zhg.Of Pol.Gjyq. K.Kerk... P.shk.	Ne funks R.S.Publi ke Pol.rendit. Pol.rrugor q.E.S.Ope r. R.S.Objek	Ne funks one ndalim parabu rgimi	Ne funksio ne kufitare migraci oni	Ne funksione opertese F.speciale (Kom reparti, ZV/kom reparti, shuf shtabi)	Ne funks opertese F.N.shpejt (Kom reparti, N/rep.ZV/kom reparti, shuf shtabi)	Drejt. Zv/drejt Pol.qark ut.shef komis.sj hef rajoni.k om r.S.B.C.	Ne funks te sherbimev e mbeshete dhe Admin ne P.Sh Shifren dhe I.Pergj ne Min e Brendshme	Ne funksio ne te drejtorise Sh.K.B. i Pergjith.	Drejt.dr ejt l-re ne funksion e Zv/drejt i
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15
Bazë	Agjent	31350	6500		6500	5500	6500	5500	30000	7000		2000	6500	
	Agjent i l-rë	32400	6500		6500	5500	6500	5500	35000	7000		2000	6500	
	Asistent	33600	6500		6500	5500	6500	5500	42000	8000		2000	6500	
	Asistent i l-rë	35000	6500		6500	5500	6500	5500	44000	8000		2000	6500	
	Kryeasistent	36100	6500		6500	5500		5500	44000	8000		2000	6500	
I mesëm	Nëninspektor	46000	6500	18500	6500	5500		5500	38000	6000		2000	6500	
	Inspektor	48300	6500	19500	6500	5500		5500	38000	6000	6000	2000	6500	
	Kryeinspektor	54250	6500	22000	6500	5500		5500	38000	6000	6000	2000	6500	
I lartë	Nënkomisar	65900	6500	27000	6500	5500		5500	31000	6000	6000	2000	6500	
	Komisar	80900	6500	33500	6500	5500		5500	31000	6000	6000	2000	6500	
	Kryekomisar	92400	6500		6500	5500		5500	31000	6000	6000	2000	6500	
Madhor	Drejues	102000	10000		10000	10000		10000	10000	10000	10000	10000	10000	20000
	Drejues i l-rë	109500												20000

VENDIM
Nr.451, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.561, DATË 16.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT SIPAS GRADAVE PËR PUNONJËSIT, OFICERË DHE NËNOFICERË, TË GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 34 të ligjit nr.8869, datë 21.3.2002 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 11 e 26, pika 1, të ligjit nr.9366, datë 31.3.2005 “Për gradat dhe karrierën në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Niveli i pagës për gradë, sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës”, që përmendet në pikën 1 të vendimin nr.561, datë 16.8.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen, me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Niveli i pagës për gradë sipas roleve për punonjësit e Gardës së Republikës

Roli i punonjësve sipas gradave		Grada	Paga bazë për gradë
Për punonjësit oficer	Madhor	Gjeneral garde	102000
	I lartë	Kolonel	88700
		N/Kolonel	78100
		Major	64500
	I mesëm	Kapiten	52700
		N/Kapiten	49760
	I ulët	Toger	46960
		N/Toger	45060
Për punonjësit nënoficer	Madhor	Kryekapter	35960
	I lartë	Kapter	35200
		Kapter shtabi	34700
		Kapter mjeshtër	34160
	I mesëm	Kapter i parë	33560
		Kapter i dytë	33100
		Kapter i tretë	32760
	I ulët	Kapter i katërt	32160
		Rreshter	31600

VENDIM

Nr.452, datë 18.7.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.369, DATË 14.6.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të

VENDOSI:

Në vendimin nr.369, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e degëve të tatimeve”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Nr.	Pozicioni	Paga individuale			Paga mujore		
		Kategoria	Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për Kushte pune
			1	2	3	4	5
1	Drejtor i Përgjithshëm	II-a	1	2%		100500	15000
2	Zv/drejtor i përgjithshëm	II-b	1	2%		84000	15000
3	Drejtor Drejtorie.	III-a	1	2%		65000	16500
4	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		49000	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		49000	13000
5	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		37450	14000
6	Inspektor i II-të	IV-b	1	2%		25850	13000
7	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		37450	15000
8	Nënoficer		2/3	2%		18760	9000
9	Llogaritar/Arkëtar		2/3	2%		31900	
10	Operator/e		2/3	2%		27400	
11	Arkivist/Protokollist		2/3	2%		30900	
12	Magaznier		3	2%		27400	
13	Sekretare	IV-b	1	2%		25850	5000
14	Shofer		3	2%		27400	
15	Punonjës pastrimi		3/4	2%		16500	

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Degëve të Tatimeve

Nr.	Pozicioni	Kategoria	Paga individuale			Paga mujore	
			Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për Kushte pune
			1	2	3	4	5
Dega e Tatimpaguesve të mëdhenj dhe Dega e Tatimeve Tiranë							
1	Kryetar dege	III-a	1	2%		65000	16500
	Nënkryetar dege	III-a/1	1	2%		55000	15000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		49000	14000
	Përgjegjës zyre	III-b	1	2%		49000	13000
3	Inspektor I I-rë	IV-a	1	2%		37450	14000
4	Inspektor I II-të	IV-b	1	2%		25850	13000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		37450	15000
	Nënoficer		2/3	2%		18760	9000
5	Operator		2/3	2%		27400	
8	Llogaritar/Arkëtar		2/3	2%		27400	
11	Shofer		3	2%		27400	
14	Arkivist/Protokollist		2/3	2%		27400	
15	Magaziniar		3	2%		26500	
16	Punonjës pastrimi		3/4	2%		16500	
Deget e Tatimeve në rrethet e tjera							
1	Kryetar dege	III-a/1	1	2%		55000	15000
2	Përgjegjës sektori	III-b	1	2%		49000	13000
	Përgjegjës zyre	IV-a	1	2%		37450	13000
3	Inspektor i I-rë	IV-a	1	2%		37450	13000
4	Inspektor i II-të	IV-b	1	2%		25850	11000
	Oficer i Policisë Tatimore	IV-a	1	2%		37450	14000
	Nënoficer		2/3	2%		18760	9000
5	Operator		2/3	2%		27400	
	Llogaritar/arkëtar		2/3	2%		27400	
	Shofer		3	2%		27400	
	Arkivist/Protokollist		2/3	2%		27400	
	Magaziniar		3	2%		26500	
	Punonjës pastrimi		3/4	2%		16500	

VENDIM
Nr.453, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.358, DATË 28.7.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS SË PAGËS SË PUNONJËSVE TË
DOGANAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të doganave”, që i bashkëlidhet vendimit nr.358, datë 28.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të Doganave

				PAGA MUJORE			
			EMËRTIMI	PAGA INDIVIDUALE		SHITESA E POZICIONIT	
Kate goria		Paga e Grupit (PG)		Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kuali fikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për Kushte pune
	II-a		Drejtor i Përgjithshëm	2%		100500	15000
	II-b		Zv/drejtor i përgjithshëm	2%		84000	15000
A	III-a	1	Këshilltar. Drejtor drejtorie. Drejtor drejtorie rajonale. Kryetar i degës doganore Tiranë, Durrës, Vlorë, Shkodër, Gjirokastrë. Nëpunës ndërlidhës i qendrës SECI.	2%		65000	17000
B	III-a/1	1	Përgjegjës/Shef sektori. Specialist i marrëdhënieve me publikun. Kryetar dege doganore Fier, Kapshticë, Korçë, Lezhë, Bllatë, Kukës, Sarandë, Berat, Tri Urat, Qafë Thanë, Elbasan. Kryehetues doganor. Shef operacionesh doganore në degën doganore Tiranë, Durrës.	2%		55000	16000
C1	III-b	1	Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme. Specialist laborator. Përkthyes. Inspektor kontrolli. Koordinator në DOH. Shef turni. Komandant grupi antikontrabande. Doganier analize risku Aposteriori, Borxhi. Jurist. Administrator rrjeti në degë doganore.	2%		49000	14500
C2	IV-a	1	Doganier kontrolli dokumentar, fizik. Llogaritar. Inspektor antikontrabande. Asistent laborator.	2%		37450	14000
C3	IV-b	2	Doganier pranues. Doganier peshoreje. Doganier pike kontrolli. Përpunues informacioni. Sekretare. Arkivist.	2%		25850	11000
D1		2	Arkëtar. Magazinier. Furnitor. Operator. Shofer. Teknik. Shoqërues.	2%		27400	
D2		3	Centralist. Sportelist. Sanitar. Mirëmbajtës.	2%		18500	
D2		4	Pastrim mirëmbajtje	2%		16500	

VENDIM
Nr.454, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.839, DATË 11.12.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGAT E USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 20 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487 datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura”, që përmendet në pikën 1 të vendimit nr.839, datë 11.12.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministra e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA BAZE SIPAS GRADES DHE VITEVE TE SHERBIMIT PER USHTARAKET AKTIVE TE FORCAVE TE ARMATOSURA

Vitet e sherbimit															
OFICERE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Gj.Lejtnant (Admiral)															145640
Gj.Major (Nenadmiral)														136910	139460
Gj.Brigade (Kunderadmiral)													107700	109700	109700
Kolonel (Kapiten i rangut I-re)											81610	83180	84900	86580	88250
Nenkolonel (Kapiten i rangut II-te)									61290	62440	63590	64840	66090	67350	68600
Major (Kapiten i rangut III-te)							46345	47185	48080	48970	49915	50860	51760		
Kapiten (Kapiten lejtnant)				39760	40430	41100	41780	42450	42780	43120	43450				
Toger (Lejtnant)			38080	38640	39080	39425	39760								
Nentoger (Nenlejtnant)	35025	35590	36155	36720	37285	37285									
Vitet e sherbimit															
NENOFICERE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
K/K/Kapter											43460	44010	45085	45610	46660
Kapter								35760	36860	38070	39280	40710	41810		
Rreshter						31750	32860	34970	36080	37190	37855				
Tetar				28420	30085	30085	30640	31195	31750	32305	32860				
Nentetar	24650	25090	25645	26755	28975	28975									
Vitet e sherbimit															
USHTARE PROFESIONISTE	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar/ detar profesionist II	24180	25000	25730	26880	28880										
Ushtar/ detar profesionist I	22610	23660													
USHTARE TE SHERBIMIT TE DETYRUESHEM E STUDENTE USHTARAKE															
Vitet e sherbimit															
	Nen 2	Mbi 2	Mbi 3	Mbi 4	Mbi 6	Mbi 8	Mbi 10	Mbi 12	Mbi 14	Mbi 16	Mbi 18	Mbi 20	Mbi 22	Mbi 24	Mbi 26
Ushtar rekrut II/ Detar II	2000														
Ushtar rekrut I/ Detar I	1500														
Studente ushtarak	1500														

VENDIM
Nr.455, datë 18.7.2007

PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PYJOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor janë, përkatësisht, sipas lidhjes nr.1 "Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e shërbimit pyjor", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për çdo vit pune, u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore, në masën 1 (një) për qind, për çdo vit pune, por jo më shumë se 25 vjet. Për llogaritjen e kësaj shtese të njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

3. Punonjësve të shërbimit pyjor, që marrin pagat sipas lidhjes nr.1 të këtij vendimi, për funksion drejtues, u jepet shtesë, mbi pagën bazë mujore, në masën 5 - 40 për qind mbi pagën bazë për klasë, sipas grupimit të mëposhtëm:

Grupi i parë	deri në 5;
Grupi i dytë	5 deri në 10;
Grupi i tretë	10 deri në 15;
Grupi i katërt	15 deri në 20;
Grupi i pestë	20 deri në 30;
Grupi i gjashtë	30 deri në 40.

4. Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përcaktojnë klasën përkatëse të pagës, për çdo pozicion pune, për punonjësit e drejtorive të shërbimit pyjor, sipas vendit të punës, nivelit arsimor, vështirësisë në detyrë dhe rrethanave të tjera, të kësaj natyre.

5. Për kushte të veçanta të shërbimit, punonjësit e shërbimit pyjor përfitojnë shtesë mbi pagë bazë, deri në 30 për qind. Masa e shtesës, për çdo vend pune, caktohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

6. Vendimi nr.185, datë 16.4.1993 i Këshillit të Ministrave "Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor", i ndryshuar, shfuqizohet.

7. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007", për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT
PYJOR

Nr rendor	Klasa	Paga baze Mujore ne leke
1	I	16000
2.	II	16300
3.	III	16500
4.	IV	17200
5.	V	17700
6.	VI	18100
7.	VII	18700
8.	VIII	19100
9.	IX	19400
10.	X	20200
11.	XI	20650
12.	XII	21000
13.	XIII	21300
14.	XIV	21600
15.	XV	21900
16.	XVI	22250
17.	XVII	22650
18.	XVIII	23100
19.	XIX	23200
20.	XX	25000
21.	XXI	25600
22.	XXII	27860
23.	XXIII	32860

VENDIM

Nr.475, datë 13.7.2007

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËS SË PRESIDENTIT, KUVENDIT DHE KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura e pagave dhe nivelet e tyre për nëpunësit civilë në Kryeministri, aparatet e

ministrive të linjës, administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, diplomë e shkollës së lartë, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

3. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) e lidhjes nr.1, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

4. Shtesa për kualifikim (kolona 4) e lidhjes nr.1, përcaktohet si më poshtë vijon:

Nëpunësit civilë dhe funksionarët politikë, në Kryeministri, ministrinë e linjës, administratën e Presidentit dhe të Kuvendit, përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën, apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Për nëpunësit civilë, kjo shtesë jepet kur përputhen kualifikimi, grada apo titulli shkencor, me përshkrimin e punës së nëpunësit, pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike, për Kryeministrinë dhe ministrinë e linjës; dhe nga njësitë e personelit, për Presidencën dhe Kuvendin.

b) Kur funksionari politik apo nëpunësi civil ka kualifikim, gradë, apo titull më të lartë, se ai i përcaktuar për pozicionin/funksionin e tij, sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet vendimit, ai do të përfitojë vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin/funksionin.

c) Kur funksionari politik apo nëpunësi civil ka kualifikim, gradë, apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin/funksionin e tij sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet vendimit, ai do të përfitojë shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën, apo titullin që ka.

ç) Në çdo rast sa më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada, apo titulli që ka funksionari politik apo nëpunësi civil, ai përfiton shtesën vetëm për gradën, apo titullin shkencor më të lartë që ka.

5. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 5 të lidhjes nr.1.

6. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit”, apo “Drejtorët” në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë në degët “Inxhinieri elektronike”, apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për pozicionet konkrete bëhet pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

7. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase bëhet në përputhje me lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave për pozicionet e punës me titull të njëjtë përcaktohen në kuadër të miratimit të strukturës dhe të organikës së secilit institucion.

8. Kategorizimi për pozicionet e veçanta të jetë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

9. Struktura dhe nivelet e pagave për zëvendësministrin dhe nëpunësit e kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përcaktohen, si më poshtë vijon:

- Zëvendësministri 129 000 lekë;

- Drejtori i kabinetit të Kryeministrit barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-a;

- Këshilltari i Kryeministrit, shefi i protokollit të Kryeministrit dhe drejtori i kabinetit të zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me zëvendësministrin;

- Ndihmësi i Kryeministrit dhe këshilltari i zëvendëskryeministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë I-b;

- Ndihmësi i zëvendëskryeministrit dhe drejtori i kabinetit të ministrit barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a;

- Këshilltari i ministrit dhe zëdhënësi barazohen në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b;

- Sekretar i Kryeministrit, Presidentit, Kryetarit

të Kuvendit, Zëvendëskryeministrit,

nënkryetarit të Kuvendit

59 000 lekë;

- Sekretar i ministrit, sekretar, sekretar i Këshilltarit

të Presidentit

47 500 lekë.

Shtesa për vjetërsi në punë për pozicionet “Sekretar i Kryeministrit”, “Sekretar i Presidentit”, “Sekretar i Kryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i zëvendëskryeministrit”, “Sekretar i nënkryetarit të Kuvendit”, “Sekretar i ministrit”, “Sekretar” dhe “Sekretar i këshilltarit të Presidentit” jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 10 050 lekë.

Këto nivele pagash zbatohen edhe për funksionet ekuivalente të administratës së Presidentit, Kuvendit dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

10. Funkionarët politikë, nëpunësit e kabineteve dhe nëpunësit civilë, që përfshihen në fushën e veprimit të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagë, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

11. Ngarkohen Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikës 4 të këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

13. Duke filluar nga data 1 korrik 2007, nëpunësit civilë në pozicionet “Përgjegjës sektori”, për të cilët në urdhrat përkatës të Kryeministrit për miratimin e strukturave dhe organeve të Kryeministrit dhe ministrive të linjës, është përcaktuar kategoria III-b, të paguhen me kategorinë III-a/1, të përcaktuar sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Vendimi nr.711, datë 27.12.2001 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, në institucionet e administratës qendrore, administratën e Presidentit dhe Kuvendit, dhe disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, ndryshuar me vendimet përkatëse”, të ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

15. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë për:

- pozicionet “Inspektor”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit, në Ministrinë e Brendshme, fillojnë nga data 5.2.2007. Përgjashtimisht për periudhën 5 shkurt 2007-1 korrik 2007, vlera e kategorisë së pagës për këta nëpunës të jetë sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

- Kryeministrinë, fillojnë nga data 2.4.2007. Përgjashtimisht për periudhën 2 prill 2007-1 korrik 2007, vlerat e kategorive të pagave për nëpunësit të këtij institucioni të jenë sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

- Ministrinë e Financave, fillojnë nga data 1.5.2007. Përgjashtimisht për periudhën 1 maj 2007-1 korrik 2007, vlera e kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni të jenë sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

- Parashikimet e tjera, fillojnë nga data 1 korrik 2007.

16. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2007:

- për emërtesat e reja, të shtuara në lidhjen nr.3, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion;

- për efekt të politikave të pagave, të përballohen nga fondet e miratuara për politikën e pagave, për vitin 2007.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KLASA	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
	<i>I</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
		Paga e grupit (PG) leke	Shtesa vjetore per Vjeters i (SHV), ne perqindje	Shtesa per Kualifikim (SHK) leke	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
I	I-a	10.050	2%		123.000
	I-b	10.050	2%		110.900
II	II-a	10.050	2%		100.500
	II-b	10.050	2%		84.000
III	III-a	10.050	2%		65.000
	III-a/1	10.050	2%		55.000
	III-b	10.050	2%		49.000
IV	IV-a	10.050	2%		37.450
	IV-b	10.050	2%		25.850

KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

Vendet e punës në Shërbimin Civil, grupohen në 4 klasa, si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e strategjisë dhe hartimin e politikave të përgjithshme, në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre politikave të përgjithshme dhe përdorimin eficient të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj, për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë ministrit ose drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I-a Sekretar i Përgjithshëm

I-b Sekretar i Përgjithshëm në Ministri
Drejtor Departamenti në Këshillin e Ministrave
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike

Klasa II: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e politikave në një fushë të caktuar dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II-a Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

II-b Drejtor Drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimit dhe opsioneve të reja politike për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e politikave në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu, edhe zgjidhjen e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të medha ose sektoreve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III-a Përgjegjës Sektori

III-a/1 Përgjegjës Sektori

III-b Specialist i nivelit të lartë

Klasa IV: Kjo klasë merret me zbatimin e politikave ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve politike mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në eksperiencën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimin.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë :

IV-a Specialist i nivelit të mesëm

IV-b Specialist

**KATEGORIZIMI I POZICIONEVE TË PUNËS PËR FUNKSIONET E
VEÇANTA NË KRYEMINISTRI DHE MINISTRITË E LINJËS**

INSTITUCIONI	POZICIONI	KATEGORIA E PAGËS
Kryeministria	Jurist në Departamentin e Legjislacionit, Koordinimit & Dokumentacionit	II-b
	Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ & Antikorrupsionit	II-b
	Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive & Koordinimit të Ndihmës së Huaj	II-b
	Koordinator në Departamentin e Legalizimit & Formalizimit të Ekonomisë Ekstraligjore	II-b
	Koordinator pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave	II-b
	Koordinator në Departamentin e Informacionit	II-b
	Drejtor i Njesisë së Teknologjisë së Informacionit dhe e - Government	II-a
Ministria e Punëve të Jashtme	Përfaqësues Ligjor i Zyrës së Përfaqësuesit Ligjor	II-b
	Drejtor i Institutit të Diasporës	II-b
Ministria e Financave	Drejtor i Njesisë së Financimeve dhe Kontraktimeve me Donatorët e Huaj	II-b
Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	Kryeinspektor i Inspektoriatit të Mjedisit	III-a
	Inspektor në Inspektoriatin e Mjedisit	III-b
Ministria e Drejtësisë	Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor	III-a
Ministria e Brendshme	Drejtor i Njesisë Antitrafik	II-a
	Përgjegjës Sektori në Departamentin e Administratës Publike	II-b
	Koordinator në Departamentin e Administratës Publike	III-a
	Inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Inspektimit	III-a
	Koordinator në Njësine Antitrafik	III-a
Ministrinë e linjës	Inspektor në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, apo sektorët e auditimit të brendshëm	III-a
		III-b

POZICIONI	KUALIFIKIMI/ GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUJ)
Zëvendësministër. Drejtor i Kabinetit të Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit. Këshilltar i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit/Zëvendëskryeministrit. Ndihmës i Presidentit/Kryetarit të Kuvendit/Kryeministrit. Sekretar i Përgjithshëm.	Profesor i asociuar.	25.000
Ndihmës i Zëvendëskryeministrit. Drejtor Kabineti i Ministrit. Këshilltar i Ministrit. Drejtor Departamenti. Drejtor i Përgjithshëm. Drejtor	Doktor i Shkencave.	20.000
	Doktor i Shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimore).	25.000
Përgjegjës Sektori. Kryeinspektor. Koordinator. Jurist. Inspektor Specialist	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë. Studime Specializuese Afatgjata.	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë (diplomuar në vendet perëndimore)	20.000

VENDIM
Nr.476, datë 18.7.2007

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.371, DATË 14.6.2006 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE
TË PAGAVE TË NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.371, datë 14.6.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 të shtohet edhe “Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit”.

2. Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lidhja nr.2, që përmendet në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shtesa për kualifikim (kolona 3), e lidhjeve nr.1 e nr.2, përcaktohet si më poshtë vijon:

Nëpunësit e institucioneve të përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret janë:

a) Shtesë përfitohet kur kualifikimi, grada apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, ai do të përfitojë vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit, ai do të përfitojë shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin që ka.

ç) Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada, apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë.”.

5. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Për pozicionet “Zëvendëstitullar i institucionit”, “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, në drejtoritë dhe sektorët teknikë të Agjencisë së Prokurimit Publik, të zbatohet shtesë për kushte pune, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.

“Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët” në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë, në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë për “kushte pune”, prej 10 000 lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për këto pozicione bëhet pas miratimit të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.”.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikës 4 të këtij vendimi.

7. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e planifikuara për rritjen e pagave, sipas ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LIDHJA NR. 1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore ne varesi te Keshillit te Ministrave/Kryeministrit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%		100.500
Zv/titullar i institucionit. Drejtore drejtorie.	II-b	10.050	2%		84.000
Anetar i organit drejtues.	III-a	10.050	2%		65.000
Pergjegjes sektori.	III-a/1	10.050	2%		55.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor	III-b	10.050	2%		49.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450
	IV-b	10.050	2%		25.850

LIDHJA NR. 2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te institucioneve
rajonale/vendore ne varesi te institucioneve qendrore ne varesi te Keshillit te
Ministrave/Kryeministrit

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit rajonar.	III-b	10.050	2%		49.000
Titullar i institucionit vendor. Pergjegjes sektori ne institucionet rajonale	IV-a	10.050	2%		37.450
Pergjegjes sektori i institucionit vendor. Specialist ne institucionet rajonale	IV-b	10.050	2%		25.850
Specialist ne institucionet vendore	IV-c	10.050	2%		19.900

POZICIONI	KUALIFIKIMI/ GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHTESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit.	Profesor i asociuar.	25.000
Zv/titullar i institucionit. Drejtor Drejtorie në institucion.	Doktor i Shkencave.	20.000
	Doktor i Shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimore).	25.000
Përgjegjës Sektori. Anëtar i organit drejtues. Specialist.	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë. Studime Specializuese Afatgjata.	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë (diplomuar në vendet perëndimore)	20.000

VENDIM
Nr.477, datë 13.7.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.726, DATË 21.12.2000 “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:
 - a) Lidhja I “Renditja e funksioneve sipas klasifikimit”, që përmendet në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - b) Lidhja nr.2 “Klasifikimi i pagave të punonjësve të administratës së lartë shtetërore dhe institucioneve qendrore”, që përmendet në pikën 1, shfuqizohet.
 - c) Lidhja II/M “Paga bazë për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen II/M “Paga bazë për punonjësit e ministrive, institucioneve të tjera qendrore, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe punonjësit mbështetës të prefekturave”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - ç) Lidhja II “Paga bazë sipas klasave” që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 - d) Lidhja II-5 “Niveli i pagave për punonjësit e ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave”, që përmendet në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

dh) Pika 12 shfuqizohet.

e) Në pikën 13 , vlera 250 lekë bëhet 300 lekë.

ë) Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Punonjësit mësimorë efektivë, që për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore, të miratuar me aktet përkatëse, paguhet për çdo orë mësimi, të kryer mbi këtë normë, si më poshtë vijon:

- Në universitete dhe shkolla të tjera të larta:

- punonjësit mësimorë efektivë me titujt “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, 1000 lekë për çdo orë 60-minutëshe;

- punonjësit mësimorë efektivë me gradën shkencore “Lektor”, 800 lekë për çdo orë 60-minutëshe;

- punonjësit mësimorë efektivë “Pedagog” dhe “Asistent”, 500 lekë për çdo orë 60-minutëshe.

- Në shkollat e mesme, 300 lekë.

- Në shkollat 9-vjeçare, 250 lekë.

Punonjësit mësimorë në shkollat e larta, në sistemin me kohë të pjesshme, të cilët për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi jashtë kohës normale të punës, paguhet për çdo orë mësimore me 400 lekë/ora.

Punonjësit e jashtëm, që japin mësim në universitete dhe shkolla të tjera të larta, për çdo orë mësimi të paguhet në të njëjtën masë me punonjësit efektivë të këtyre institucioneve.”.

f) Në pikën 19, pas fjalëve “... Akademisë së Shkencave...” shtohen fjalët “...Qendrat Spitalore Universitare...”.

g) Pika 22 ndryshohet, si më poshtë:

“22. Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “A”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, kur nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, por janë punonjës civilë, përfitojnë pagën sipas klasës VII të lidhjes II/M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “B” dhe në grupin “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, shoferi i kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe shoferët e funksionarëve të barazuar me ta në pagë me ligje të veçanta, përfitojnë pagën sipas klasës së VI-të të lidhjes II/M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

- Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “D” dhe “E”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferët e titullarëve të tjerë, përkatësisht: zëvendësministrit, sekretarëve të Përgjithshëm në ministritë e linjës, sekretarëve të Përgjithshëm në institucionet e pavarura kushtetuese dhe në institucionet e tjera të pavarura të krijuara me ligje të veçanta, prefektit të qarkut Tiranë, rektorëve të Universiteteve, titullarëve të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe në varësi të ministrave të linjës, titullarëve të gjykatave të apelit, të gjykatave të apelit për krimet e rënda, të gjykatave të rretheve gjyqësore, të gjykatave për krimet e rënda, drejtorit të zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor, përfitojnë pagën sipas klasës V të lidhjes II/M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

gj) Pika 23 shfuqizohet.

h) Në lidhjen II-A, kreu II, “Shtesa të tjera”, pika 16, ndryshohet, si më poshtë vijon:

- “Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “A”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, kur nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, por janë punonjës civilë, përfitojnë 50 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

- Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupet “B” e “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferi i kryetarit të Akademisë së Shkencave e shoferët e funksionarëve, të barazuar me ta në pagë, me ligje të veçanta, përfitojnë 40 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

- Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “D” e “E”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferët e titullarëve të tjerë përkatësisht: zëvendësministrit, sekretarëve të Përgjithshëm në ministritë e linjës, sekretarëve të Përgjithshëm në institucionet e pavarura kushtetuese dhe në institucionet e tjera të pavarura, të krijuara me ligje të veçanta, prefektit të qarkut Tiranë, rektorëve të universiteteve, titullarëve të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe në varësi të ministrave të linjës, titullarëve të gjykatave të apelit, të

gjykatave të apelit për krimet e rënda, të gjykatave të rretheve gjyqësore, të gjykatave për krimet e rënda, drejtorit të zyrës së administrimit të buxhetit gjyqësor, dhe shoferët e tjerë të aparatit të Presidencës, Kuvendit dhe Kryeministrit, përfitojnë 30 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.”.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fonde për rritjen dhe reformën në sistemin e pagave, të parashikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i shkronjës “ë” të pikës 1 të këtij vendimi, për punonjësit mësimorë efektivë të universiteteve dhe shkollave të tjera të larta, të përballohen nga të ardhurat e vetë e universiteteve dhe shkollave të tjera të larta, dhe të fillojnë të zbatohen për vitin akademik 2007-2008.

4. Efektet financiare për pozicionin “Këshilltar i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura” të fillojnë nga data e emërimit të nëpunësit në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja I

RENDITJA E FUNKSIONEVE SIPAS KLASIFIKIMIT

A1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	162850
A2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave. Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave.	129000
A3	Akademik.	117000
A4	Profesor në universitete e shkolla të tjera të larta, në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Qendrat Spitalore Universitare. Këshilltar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.	100500
A5	Profesor i asociuar në universitete e shkolla të tjera të larta, në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Qendrat Spitalore Universitare. Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm.	87500
A6		
B1	Profesor në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Lektor. Punonjës kërkimor në universitete e shkolla të tjera të larta, në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Qendrat Spitalore Universitare.	75500
B2		
B3	Profesor i asociuar në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Pedagog. Kërkues në universitete e shkolla të tjera të larta, në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Qendrat Spitalore Universitare. Rektor (pa titull/gradë shkencore).	65500
B4	Asistent në shkollat e larta, në institutet kërkimore shkencore të sistemit të Akademisë së Shkencave dhe në Qendrat Spitalore Universitare. Drejtor drejtorie në Shkollën e Magjistraturës.	53500
B5	Punonjës kërkimor në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Përgjegjës Zyre në Prokurorinë e Përgjithshme. Inspektor kontrolli në Prokurorinë e Përgjithshme. Përkthyes në Prokurorinë e Përgjithshme.	43000
C1		43000
C2	Kërkues në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Informaticien në Gjykatat e shkallës së parë dhe në Gjykatat e Apelit.	39000
C3	Asistent në institutet kërkimore shkencore në varësi të ministrive. Sekretar i Kancelarit të Gjykatës së Lartë.	33700

LIDHJA II**PAGA BAZE SIPAS KLASAVE**

Nr rendor	Klasa	Paga bazë Mujore në lekë
1	I	16000
2	II	16400
3	III	16800
4	IV	17300
5	V	18000
6	VI	18500
7	VII	19000
8	VIII	19500
9	IX	20000
10	X	22000
11	XI	23000
12	XII	23600
13	XIII	24900
14	XIV	30600

**Paga bazë për punonjësit e ministrive,
institucioneve të tjera qendrore dhe prefekturave**

Nr rendor	Klasa	Paga bazë Mujore në lekë
1	I	16000
2	II	16400
3	III	16800
4	IV	17300
5	V	18000
6	VI	18800
7	VII	22300
8	VIII	24500
9	IX	27200
10	X	34000

NIVELI I PAGAVE PËR PUNONJËSIT E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE
TË TJERA QENDRORE DHE PREFEKTURAVE

Nr.	EMËRTIMI I PUNONJESIT	Niveli i Pagëes Klasa	Shtesë për funktion (grupi)
1	Sekretari Komisionit të Kualifikimit Shkencor	X	6
	Kryesekretar i Shkolles së Magjistratures	X	
	Shef Sektori. Kryetar dege	IX	5
	Përgjegjës Zyre	IX	3
	Specialist i parë. Inspektor i parë	VIII	
	Specialist i dytë. Inspektor i dytë. Sekretar i titullareve të tjere. Arkivist. Protokollist. Kryellogaritar.	VII	
	Përgjegjës administratë. Përgjegjës oficine e transporti.	VI	1
	Llogaritar i I-re. Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme . Përkthyes. Shifrant (MPJ)	VI	
	Operator i terminaleve. Llogaritar.	V	
	Shofer Magazinier. Daktilografist. Shaptilografiste. Fotokopjuese. Arkëtar. Korrier diplomatik. (MPJ) Shpërndareshifre. (MPJ) Spedicioner. (MPJ)	IV	
	Punëtor	II-IV	
	Nepunës informacioni	II	
	Portier. Pastrues. Korrier. Kafaz i salloneve të pritjes. (MPJ)	I	

VENDIM
Nr.478, datë 18.7.2007

**PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen institucionet qendrore dhe ato rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, të cilët, në kuptim të këtij vendimi, kategorizohen, si më poshtë vijon:

a) Institucione qendrore, të grupit të parë, ku bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetës-Kanalizimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror të Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Enti i Turizmit, Komiteti Shtetëror i Kulteve, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit.

b) Institucione qendrore, të grupit të dytë, ku bëjnë pjesë: Instituti i Studimeve të Transportit, Instituti i Studimeve të Urbanistikës, Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, Instituti i Kurrikulave dhe Trajnimit, Agjencia e Akreditimit për Arsimin e Lartë, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit Gjyqësor, Qendra e Publikimeve Zyrtare, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Reparti i Inspektim-Shpëtim-Minierave, Policia Elektrike, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, Instituti i Monumenteve të Kulturës, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Komiteti Olimpik Shqiptar, Galeria Kombëtare e Arteve, Muzeu Historik Kombëtar, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, Biblioteka Kombëtare, Teatri Kombëtar, Inspektorati Qendror Teknik, Qendrat e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Qendra Kombëtare e Regjistrimit, Agjencia Shqiptare e Biznesit dhe Investimeve, Drejtoria e Akreditimit dhe Komiteti Shqiptar i Birësimeve.

c) Institucione qendrore të grupit të tretë, ku bëjnë pjesë: Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, Durrës, Inspektorati Hekurudhor, Durrës, Qendra Pritëse e Viktimave të Trafikut, Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve, Agjencia Kombëtare e Duhan-Cigareve, Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurive Kulturore, Qendra e Realizimit të Veprave të Artit, Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Butrintit, Sarandë, Zyrat e Administrimit dhe Koordinimit të Parqeve Arkeologjike, Agjencia e Shërbimeve të Sportit, Tiranë, Fototeka Kombëtare “Marubi”, Shkodër, Muzeu Kombëtar “Gjergj Kastrioti”, Krujë, Qendra Kombëtare e Muzeumeve, Berat, Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë, Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar, Korçë, Agjencia e Mjedisit dhe e Pyjeve, Klubi Shumësportësh “Partizani” dhe federatat e sportit.

2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të parë, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të jenë sipas lidhjes nr.1/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i

institucionit”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, të jenë sipas lidhjes nr.1/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, të jenë sipas lidhjes nr.1/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/4. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të jenë sipas lidhjes nr.1/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2/5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të jenë sipas lidhjes nr.1/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të dytë, të përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të jenë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të jenë sipas lidhjes nr.2/1-a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Struktura dhe nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të jenë sipas lidhjes nr.2/1-b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr.2/1-b, jepet në masën 2 për qind, për çdo vit pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi vlerën 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë. Punonjësit e trupës artistike të këtyre institucioneve përfitojnë shtesë, për kushte pune, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në muaj.

3/2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në qendrat e transferimit të teknologjive bujqësore, të jenë sipas lidhjes nr.2/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Niveli i pagave për punonjësit, që paguhen nga të ardhurat e veta për këto institucione, i referohet nivelit të pagave të punonjësve, që paguhen nga Buxheti i Shtetit.

4. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve qendrore të grupit të tretë, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të ministrave të linjës, të institucioneve rajonale/vendore, në varësi të institucioneve, të përcaktuara në pikën 1, si dhe të punonjësve, që kryejnë funksione të deleguara të pushtetit qendror në pushtetin vendor, të jenë sipas lidhjes nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/1. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në rrethe, të jenë sipas lidhjes nr.4/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/2. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, të jenë sipas lidhjes nr.4/2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/3. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në drejtoritë e burgjeve dhe institucionet e riedukimit në rrethe, të jenë sipas lidhjes nr.4/3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/4 Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në zyrat rajonale/vendore të Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Informale, të jenë sipas lidhjes nr.4/4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5/5. Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve, në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në zyrat rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të jenë sipas lidhjes nr.4/5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Paga e grupit (kolona 1), diplomë e shkollës së lartë, e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr.1/3,

nr.1/4, nr.1/5, nr.2, nr.2/1-A, nr.2/2, nr.3, nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5, është 10 050 (dhjetë mijë e pesëdhjetë) lekë.

7. Shtesa për vjetërsi në punë, (kolona 2), e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr.1/3, nr.1/4, nr.1/5, nr.2, nr.2/1-A, nr.2/2, nr.3, nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5, jepet në masën 2 për qind, pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe llogaritet mbi pagën e grupit.

8. Shtesa për kualifikim, (kolona 3), e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr.1/3, nr.1/4, nr.1/5, nr.2, nr.2/1-A, nr.2/1-B, nr.2/2, nr.3, nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5, përcaktohet, si më poshtë vijon: Nëpunësit në institucionet e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën, apo titullin shkencor, të përcaktuar sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Kriteret e përfitimit të shtesës janë:

a) Kjo shtesë jepet kur kualifikimi, grada, apo titulli shkencor, përputhen me përshkrimin e punës së nëpunësit, por pas miratimit, rast pas rasti, nga Departamenti i Administratës Publike.

b) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë, apo titull më të lartë se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton vetëm shtesën e përcaktuar për pozicionin.

c) Kur nëpunësi ka kualifikim, gradë, apo titull më të ulët se ai i përcaktuar për pozicionin e tij, sipas lidhjes nr.5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfiton shtesën në përputhje me kualifikimin, gradën apo titullin që ka.

ç) Në çdo rast si më sipër, pavarësisht nga kualifikimi, grada, apo titulli, që ka nëpunësi, ai përfiton shtesën vetëm për gradën apo titullin shkencor më të lartë që ka.

9. Shtesa për pozicion është sipas kolonës 4, e lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr.1/3, nr.1/4, nr.1/5, nr.2, nr.2/1-A, nr.2/2, nr.3, nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5.

10. Kategorizimi për secilin institucion, për pozicionet “Drejtor drejtorie”, “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist”, përcaktohet në urdhrin e miratimit të strukturës dhe të organikës së institucionit.

11. Punonjësit, që punojnë në pozicionet “Specialist” deri në “Titullar i institucionit”, në institucionet rajonale/vendore dhe që nuk përmbushin kriterin e arsimit të lartë, të trajtohen në pagë sipas strukturës, së përcaktuar në lidhjet nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5, që i bashkëlidhen këtij vendimi, por paga e grupit do të llogaritet me 50 për qind të pagës së grupit, për diplomën e shkollës së lartë, sipas përcaktimit të bërë në pikën 6 të këtij vendimi. Shtesa për vjetërsi në punë për këta punonjës të llogaritet mbi këtë pagë të reduktuar.

12. “Specialistët”, “Përgjegjësit e sektorit” apo “Drejtorët”, në institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, që punojnë në pozicione, që lidhen me procesin e informatizimit të veprimtarisë së administratës publike dhe kërkojnë, në mënyrë të detyrueshme, arsimin e lartë në degët “Inxhinieri elektronike” apo “Informatikë”, përfitojnë një shtesë, për kushte pune, prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh mbi pagën mujore të kategorisë përkatëse. Zbatimi i kësaj shtese për këto pozicione bëhet pas miratimit të Departamentit të Administratës Publike dhe Ministrisë së Financave, sipas përshkrimit të pozicioneve të punës.

Punonjësit në pozicionet “Përgjegjës sektori” dhe “Specialist/laborant”, në laboratorët e naftës dhe të gazit dhe laboratorët e lëkurë — tekstileve, si dhe punonjësit në pozicionet “Inspektor” të naftës dhe të gazit, në doganë, autobot, cisternë dhe depozitë tokësore, në Inspektoratin Qendror Teknik, përfitojnë shtesën për pasojat e punës në shëndet, sipas përcaktimeve në vendimin nr.726, datë 21.12.2000 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.

13. Nëpunësit, që paguhën sipas lidhjeve nr.1, nr.1/1, nr.1/2, nr.1/3, nr.1/4, nr.1/5, nr.2, nr.2/1-A, nr.2/2, nr.3, nr.4, nr.4/1, nr.4/2, nr.4/3, nr.4/4 dhe nr.4/5, që i bashkëlidhen këtij vendimi, dhe pikave 11 e 12 të këtij vendimi, nuk përfitojnë shtesa të tjera, të përcaktuara me vendime të tjera të Këshillit të Ministrave.

14. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Financave dhe Departamenti i Administratës Publike të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e pikës 8 të këtij vendimi.

15. Vendimi nr.407, datë 21.6.2006 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”, të ndryshuar, si dhe të gjitha dispozitat, që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

16. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për:

- Agjencinë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, të fillojnë nga data 15 mars

2007. Përfashtimit për periudhën 15 mars 2007-1 korrik 2007, vlerat e kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni të jenë sipas vendimit nr.407, datë 21.6.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

- Institutin e Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë, të fillojnë nga data 1 qershor 2007. Përfashtimit për periudhën 1 qershor 2007-1 korrik 2007, vlerat e kategorive të pagave për nëpunësit e këtij institucioni të jenë sipas vendimit nr.407, datë 21.6.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar;

- Të gjitha parashikimet e tjera, të fillojnë nga data 1 korrik 2007.

17. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave, në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

Struktura dhe nivelet e pagave të nëpunësve në institucionet qendrore të Grupit të Pare

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%		100.500
Zv/titullar i institucionit.	II-b	10.050	2%		84.000
Drejtor Drejtorie. Anetar i organit drejtues. Menaxher Trainimi.	III-a	10.050	2%		65.000
Përgjegjës Sektori	III-a/1	10.050	2%		55.000
Përgjegjës Sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%		49.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450
	IV-b	10.050	2%		25.850

Lidhja nr. 1/1

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Zyren Qendrore te Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Kryeregjistruesi.	II-a	10.050	2%		100.500	13.000
Zevendes kryeregjistruesi.	II-b	10.050	2%		84.000	13.000
Drejtor Drejtorie.	III-a	10.050	2%		65.000	15.000
Pergjegjes Sektori.	III-a/1	10.050	2%		55.000	10.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%		49.000	5.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
	IV-b	10.050	2%		25.850	5.000

Lidhja nr. 1/2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit.	II-a	10.050	2%		100.500	10.000
Zevendestitullar i institucionit.	II-b	10.050	2%		84.000	8.000
Drejtor Drejtorie.	III-a	10.050	2%		65.000	6.000
Pergjegjes Sektori.	III-a/1	10.050	2%		55.000	6.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor	III-b	10.050	2%		49.000	0
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450	5.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450	0

Lidhja nr. 1/3

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Agjencise se Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit te Zonave Informale

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	II-a	10.050	2%		100.500	13.000
Zevendestitullar i institucionit	II-b	10.050	2%		84.000	13.000
Drejtor Drejtorie.	III-a	10.050	2%		65.000	15.000
Pergjegjes Sektori	III-a/1	10.050	2%		55.000	10.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%		49.000	5.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
	IV-b	10.050	2%		25.850	5.000

Lidhja nr. 1/4

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit te Pronave

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullari i institucionit	II-a	10.050	2%		100.500	13.000
Zevendestitullari i institucionit	II-b	10.050	2%		84.000	13.000
Pergjegjes Sektori	III-a/1	10.050	2%		55.000	10.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor.	III-b	10.050	2%		49.000	5.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
	IV-b	10.050	2%		25.850	5.000

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne pozicionet "specialist" deri ne "titullar i institucionit" ne Institutin e Sigurise Ushqimore dhe Veterinarise

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			PAGA MUJORE
		1	2	3	SHTESA E POZICIONIT
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit.	II-a	10.050	2%		100.500
Pergjegjes Departamenti.	III-a	10.050	2%		65.000
Pergjegjes Sektori, ne Sektoret e Permbajtjes. Drejtore ne Drejtorite Mbeshtetese.	III-a/1	10.050	2%		55.000
Pergjegjes Sektori, ne Sektoret Mbeshtetese. Specialist me grada e tituj shkencore, ne Departamentet dhe Sektoret e Permbajtjes.	III-b	10.050	2%		49.000
Specialist pa grada e tituj shkencore ne departamentet dhe sektoret e permbajtjes.	IV-a	10.050	2%		37.450
Specialist zbatues pa grada e tituj shkencore ne departamentet dhe sektoret e permbajtjes. Specialist ne sektoret mbeshtetese.	IV-b	10.050	2%		25.850

Lidhja nr. 2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore te Grupit te Dyte

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%		84.000
Zv/titullar i institucionit. Drejtor Drejtorie. Ekspert Mjeko - Ligjor ne Institutin e Mjekesise Ligjore.	III-a	10.050	2%		65.000
Drejtor Drejtorie. Kryeredaktor ne Qendren e Publikimeve Zyrtare. Pergjegjes Sektori. Ekspert Toksikologo – Ligjor ne Institutin e Mjekesise Ligjore. Ekspert Psikiater – Ligjor ne Institutin e Mjekesise Ligjore. Ekspert Biologo – Ligjor ne Institutin e Mjekesise Ligjore. Ekspert Mjeko – Ligjor prane gjykatave te apelit.	III-a/1	10.050	2%		55.000
Pergjegjes Sektori. Redaktor i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Inspektor.	III-b	10.050	2%		49.000

Specialist. Informaticien (Specialist i teknologjise se informacionit) i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Informaticien (Specialist i teknologjise se informacionit) ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Korrektor i Qendres se Publikimeve Zyrtare. Kurator. Inspektor. Bibliograf. Klasifikator. Bibliotekar. Restaurator. Lektor. Administrator. Redaktor. Studiues.	IV-a	10.050	2%		37.450
	IV-b	10.050	2%		25.850

Lidhja nr. 2/1-A

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne pozicionet "Specialist" deri ne "Titullar i institucionit" ne Teatrin Kombetar, Teatrin Kombetar te Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe ne Qendren Kombetare te Kultures per Femije

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	II-b	10.050	2%		84.000
Zv/titullar i institucionit. Drejtore Drejtorie.	III-a	10.050	2%		65.000
Pergjegjes Sektori.	III-a/1	10.050	2%		55.000
Pergjegjes Sektori.	III-b	10.050	2%		49.000
Specialist.	IV-a	10.050	2%		37.450
Mjek.	IV-b	10.050	2%		25.850

Lidhja nr. 2/1-B

Struktura dhe nivelet e pagave te punonjeseve te trupes artistike ne Teatrin Kombetar, Teatrin Kombetar te Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe ne Drejtorine e Teatrit te Femijeve, ne Qendren Kombetare te Kultures per Femije

I- Per Teatrin Kombetar dhe Drejtorine Artistike te Teatrit te Operas dhe Baletit, ne Teatrin Kombetar te Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent. Regjisor. Solist i pare. Koncertmaester. Baletmaester. Aktor i pare	59.992 leke
2	Asistent dirigjent. Asistent regjisor. Solist II (spala sektori). Aktor i dyte	53.478 leke
3	Orkestrant i kategorise se pare. Korist i kategorise se pare. Balerin i kategorise se pare. Aktor i trete. Skenograf i kategorise se pare.	42.621 leke
4	Orkestrant i kategorise se dyte. Korist i kategorise se dyte. Balerin i kategorise se dyte. Aktor i trete. Skenograf i kategorise se dyte.	31.764

II- Per Drejtorine Artistike te Ansamblit te Kengeve dhe Valleve Popullore, ne Teatrin Kombetar te Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Drejtorine e Teatrit te Femijeve, ne Qendren Kombetare te Kultures per Femije

Nr	Pozicioni	Paga
1	Dirigjent. Regjisor.	53.478 leke
2	Solist i pare. Orkestrant i kategorise se pare. Aktor i pare. Skenograf i kategorise se pare. Korist i kategorise se pare.	42.621 leke

	Valltar i kategorise se pare.	
3	Solist i dyte. Orkestrant i kategorise se dyte. Aktor i dyte. Skenograf i kategorise se dyte. Korist i kategorise se dyte. Valltar i kategorise se dyte.	31.764

Lidhja nr. 2/2

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne pozicionet “specialist” deri ne “titullar i institucionit”, ne Qendrat e Transferimit te Teknologjiwe Bujqesore

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit.	II-b	10.050	2%		84.000
Pergjegjes Departamenti.	III-a	10.050	2%		65.000
Pergjegjes Sektori, ne Sektoret e Permbajtjes.	III-a/1	10.050	2%		55.000
Pergjegjes Sektori, ne Sektoret Mbeshtetes. Specialist me grada e tituj shkencore, ne Departamentet dhe Sektoret e Permbajtjes.	III-b	10.050	2%		49.000
Specialist pa grada e tituj shkencore ne Departamentet dhe Sektoret e Permbajtjes.	IV-a	10.050	2%		37.450
Specialist zbatues pa grada e tituj shkencore ne Departamentet dhe Sektoret e Permbajtjes. Specialist ne Sektoret Mbeshtetes.	IV-b	10.050	2%		25.850

Lidhja nr. 3

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne institucionet qendrore te Grupit te Trete

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit. Kapiten i Pergjithshem i Kapitenerise se Pergjithshme te Porteve.	III-a	10.050	2%		65.000
Drejtor Drejtorie. Zv/kapiten i Kapitenerise se Pergjithshme te Porteve.	III-b	10.050	2%		49.000
Pergjegjes Sektori. Inspektor.	IV-a	10.050	2%		34.450
Specialist. Restaurator. Lektor. Arkivist/Katalogist. Historian.	IV-b	10.050	2%		25.850
	IV-c	10.050	2%		19.900

Lidhja nr. 4

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te institucioneve rajonale/vendore ne varesi te ministrave te linjes, institucioneve rajonale/vendore ne varesi te institucioneve qendrore ne varesi te ministrave te linjes, si dhe te punonjesve qe kryejne funksione te deleguara te pushtetit qendror ne pushtetin vendor dhe sekretaret e deputeteve

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit rajonal. Kryetar i Zyres se Permbarimit. Kryetar i deges se Thesarit Tirane. Pergjegjes i degeve te thesarit ne qender qarku. Pergjegjes seksioni ne Seksionet e Administrimit dhe te Mbrojtjes se Tokes ne Qarqe. Kryeinspektor ne Inspektoriatet e Mbrojtjes se Tokes ne Qarqe.	III-b	10.050	2%	0	49.000
Titullar i institucionit vendor. Pergjegjes Sektori ne institucionet rajonale. Pergjegjes Sektori ne Degen e Thesarit Tirane. Pergjegjes te degeve vendore te thesarit. Pergjegjes i zyres se gjendjes civile ne bashki (si funksion i deleguar). Permbarues Gjyqesor ne Zyrrat e Permbarimit Gjyqesor.	IV-a	10.050	2%	0	37.450

Pergjegjes Sektori i institucionit vendor. Pergjegjes i zyres se gjendjes civile ne komuna (si funksion i deleguar). Specialist i zyres se gjendjes civile ne bashki (si funksion i deleguar). Specialist ne institucionet rajonale. Restaurator arti. Arkitekt. Inspektor ne Inspektoriatin e Mbrojtjes se Tokes ne Qarqe. Specialist ne deget e thesarit.	IV-b	10.050	2%	0	25.850
Specialist ne institucionet vendore. Specialist i zyres se gjendjes civile ne komuna (si funksion i deleguar). Restaurator. Instruktor. Piktor. Sekretar deputeti.	IV-c	10.050	2%	0	19.900

Lidhja nr. 4/1**Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Zyrave te Regjistrimit te Pasurive te
Paluajtshme ne rrethe**

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Regjistruer i Tiranes	III-a	10.050	2%		65.000	15.000
Regjistruer i rretheve te kategorise se I-re.	III-a/1	10.050	2%		55.000	16.500
Regjistruer i rretheve te kategorise se II-te. Zevendesregjistruer i rretheve te kategorise se I-re.	III-b	10.050	2%		49.000	16.500
Zevendesregjistruer ne zyrat e kategorise se II-te.	IV-a	10.050	2%		37.450	16.500
Pergjegjes Sektori ne zyrat e regjistrimit te kategorise se I-re.	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
Pergjegjes Sektori ne zyrat e regjistrimit te kategorise se II-te. Specialist ne zyrat e regjistrimit te kategorise se I-re.	IV-b	10.050	2%		25.850	10.000
Specialist ne zyrat e regjistrimit te kategorise se II-te.	IV-c	10.050	2%		19.900	6.000

Shenim: Zyrat e Regjistrimit te kategorise se I-re, jane zyrat: Tirane, Berat, Durres, Elbasan, Fier, Gjirokaster, Kavaje, Korçe, Lezhe, Lushnje, Pogradec, Shkoder, Vlore, Diber dhe Sarande.

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	4
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetërsi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Drejtor i Drejtorive Arsimore Rajonale.	III-b	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	49.000
Drejtor i Zyrave Arsimore. Pergjegjes Sektori ne Drejtorite Arsimore Rajonale.	IV-a	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	37.450
Pergjegjes Sektori ne Zyrat Arsimore. Specialist ne Drejtorite Arsimore Rajonale.	IV-b	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	25.850
Specialist ne Zyrat Arsimore.	IV-c	10.050	2%	Shkalla e trete - 10% Shkalla e dyte - 20% Shkalla e pare - 30%	19.900

Lidhja nr. 4/3

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve ne Drejtorite e Burgjeve dhe Institucionet e Riedukimit ne rrethe

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	III-a	10.050	2%	0	65.000	10.000
Zevendestitullar i institucionit.	III-b	10.050	2%	0	49.000	8.000
Pergjegjes Sektori.	IV-a	10.050	2%	0	37.450	5.000
Specialist.	IV-b	10.050	2%	0	25.850	4.000

Lidhja nr. 4/4

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Zyrrave (Drejtorive) Rajonale, te Agjencise se Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit te Zonave/Ndertimeve Informale

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Drejtor i Zyres (drejtorise) rajonale, Tirane	III-a	10.050	2%		65.000	15.000
Drejtor i Zyrrave (drejtorive) Rajonale te kategorise se pare. Zv/drejtor i Zyres (drejtorise) Rajonale, Tirane	III-a/1	10.050	2%		55.000	16.500
Drejtor i Zyrrave (drejtorive) rajonale te kategorise se dyte. Zv/drejtor i Zyrrave (drejtorive) rajonale te kategorise se pare.	III-b	10.050	2%		49.000	16.500
Pergjegjes Sektori ne Zyrat (drejtorite) rajonale.	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
Specialist ne Zyrat (drejtorite) rajonale	IV-b	10.050	2%		25.850	10.000

Shenim: Zyrat (drejtorite) rajonale te kategorise se pare te ALUIZNIt-t jane: Tirane, Durres, Vlore, Elbasan, Fier, Shkoder, Lezhe, Korçe, Berat.

Lidhja nr. 4/5

Struktura dhe nivelet e pagave te nepunesve te Zyrave Rajonale te Agjencise se Kthimit dhe Kompensimit te Pronave

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHITESA E POZICIONIT	SHITESA PER KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e Grupit (PG)	Shtesa vjetore per vjetarsi (SHV)	Shtesa per Kualifi kim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullar i institucionit	III-b	10.050	2%		49.000	16.500
Pergjegjes sektori	IV-a	10.050	2%		37.450	10.000
Specialist ne institucionet rajonale.	IV-b	10.050	2%		25.850	10.000

Lidhja nr. 5

POZICIONI	KUALIFIKIMI/ GRADA/TITULLI SHKENCOR	SHITESA (LEKË/MUAJ)
Titullar i institucionit.	Profesor i asociuar.	25.000
Zv/titullar i institucionit. Drejtore Drejtorie në institucion. Anetar i organit drejtues.	Doktor i Shkencave.	20.000
	Doktor i Shkencave (doktoraturë e mbrojtur në vendet perëndimore).	25.000
Përgjegjës Sektori. Menaxher trainimi. Specialist.	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë. Studime Specializuese Afatgjata.	10.000
	Studime të thelluara pasuniversitare/Master i Nivelit të Dytë (diplomuar në vendet perëndimore)	20.000

VENDIM
Nr.480, datë 1.8.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.216, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURAT E KONKURRIMIT PUBLIK, PËR PËRZGJEDHJEN E SUBJEKTEVE TË LICENCUARA, PËR RESTAURIMIN E MONUMENTEVE TË KULTURËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me porpozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.216, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 2, të kreut I, pas togfjalëshit “Instituti i Kulturës Popullore...” shtohen fjalët “...apo Ministria e Turizmit , Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.”.

2. Paragrafi i katërt, i pikës 1, të kreut II, ndryshohet si më poshtë, vijon:

“Juristi i komisionit ka për detyrë zbatimin e ligjit gjatë të gjithë zhvillimit të procedurës së konkurrimit, mbajtjen e procesverbaleve të punës së komisionit, administrimin e dosjeve përkatëse, si dhe përgatit çdo komunikim me shkrim, për procedurën e zhvilluar deri në lidhjen e kontratës.

Njësia e vlerësimit ka për detyrë vlerësimin e ofertave ekonomike, si dhe shpalljen e ofertës më të mirë ekonomike.

Procesverbalet e punës nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit. Përgjegjës për zbatimin e kontratës është institucioni, i cili është i autorizuar për lidhjen e kontratës.”.

3. Në fund të pikës 2, të kreut III, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Ankesat për procedurën e zhvilluar në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i drejtohen Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Vendimi i tij është përfundimtar.”.

4. Në pikën 1, të kreut IV, hiqen fjalët:

“...dhe që ka zhvilluar konkurrimin...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 1.8.2007
Doli nga shtypi më 3.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 76 lekë